



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 06/2011
Prishtinë, më 19.04.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Munguan: Fikrim Damka dhe Visar Ymeri.

Të ftuarit për raportim: Ahmet Tmava, Ibush Jonuzi, Enver Breznica dhe Azem Rexhaj – KPMM.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi- USAID, Besim Zeqiri- ICO, Besnik Ramadanaj – KDI, Lejla Selimi - OSCE dhe Lumnije Murati ZPRK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.04.2011;
3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim;
4. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare;
5. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;

6. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – kërkoj nga anëtarët e Komisionit që pikën e gjashtë (6) të rendit të ditës të vendoset si pika e tretë për të pjesëmarrjes së delegacionit të KPMM-së. Ndërsa pikat tre (3), katër (4) dhe pesë (5) të rendit të ditës të shqyrtohen si një pikë e rendit të ditës si pika e katërt (4) për shkak të natyrës së lëndës.

Propozimi u përkrash nga Komisioni dhe rendi i ditës u miratua si në vijim:

1. *Miratimi i rendit të ditës;*
2. *Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.04.2011;*
3. *Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010;*
4. *Shqyrtimi në parim i Projektligjeve: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;*
5. *Të ndryshme.*

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.04.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 12.04.2011 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010;

Kryetari – e ftoi përfaqësuesin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale që ta paraqesë Raportin vjetor për vitin 2010.

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) - konform Ligjit KPMM ka përgatitur Raportin vjetor për vitin 2010. Viti i kaluar ka startuar në shkurt me formimin e dhe emërimin e Bordit të ri dhe për mungesë nga viti paraprak për gjashtë muaj të Bordit ka qenë një grumbullim i punëve të detyrave dhe përgjegjësisë të KPMM-së. Problem ka qenë edhe ende mbesin operuesit ilegal, edhe pse në këtë aspekt është bërë një punë shumë e madhe dhe kjo punë e madhe shihet në bazë të mbledhjes se të dhënave të taniemave që e reflekton punën dhe efikasitetin e KPMM-së. Sepse kemi një rritje qind për qindëshe edhe kjo rritje e taniemave edhe për buxhetin e Kosovës e reflekton punën edhe angazhimin. Mirëpo për të qenë më vetë kritik kemi bërë takime të shumta në mënyrë që ta çrrënjosisim operuesit ilegal, kemi pasur takime të shumta kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi me shumë komuna edhe me shumë institucione tjera me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Ministrinë e Mjedisit, me Agjencionin kadastral edhe me të gjitha institucionet relevante që mund të kyçen, e sidomos moment kyç është themelimi i Agjencionit për menaxhimin e mallit të konfiskuar. Kemi bërë kallëzime penale dhe puna e komisionit ka reflektua në suaza dhe detyrat që i kemi por ne mendojmë që do të çrrënjohet operuesi ilegal në momentin kur në institucionet tjera hyn në

lëvizje. Esenca e krejt kësaj është që sigurisht që është këtu sepse sa i përket operuesve të tjerë të cilët janë të licencuar dhe kemi mekanizma që ti kemi në kontroll jashtë procedurave të kallëzimeve penale.

Kryetari – shtroj çështjen e sfidës së evidentuar në Raport të progresit, që është një çështje mjaft esenciale për punën e Komisionit, që ka të bëjë me Ligjin për Miniera dhe Minerale. Sipas këtij Raporti rrezikohet pavarësia e KPMM-së, duke bartur përgjegjësinë për emërimin e kryeinspektorit për inspektoratin e minierave nga ana e Qeverisë. Cili është opinionin juaj nga aspekti praktik i funksionimit?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) - ish kryeinspektori është ende kryes detyre i kësaj pozite konform ligjit d.m.th emërohet nga institucionet qeveritare dhe i raporton Qeverisë. Mirëpo deri më tani nuk kemi hasur në probleme. Inspektorati është departament i KPMM-se edhe si departament mënyra si hierarki është konform ligjit gjë për të cilin nuk dëshiroj ta komentoj më shumë.

Kryetari - Ju e përmendet edhe funksionimin e Agjencionit për menaxhimin e mallrave të konfiskuar, kur pritni që kjo duhet me u kompletuar?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) - kemi informacione se në fund të dhjetorit të kaluar por ende nuk është kompletuar krejtësisht sistemi si institucion për të vepruar.

Berat Buzhala - te veprimtarit ilegale keni parashtruar vetëm 268 kallëzime penale për të gjitha rastet, po vetëm për 170 raste janë shqyrtuar, edhe neni 70 i Ligjit për Miniera flet për këtë çështje. Pse duhet të komplikohet kaq shumë puna kur Ligji është shumë i qartë, pse duhet me Ministrinë e Ambientit me pas memorandume? Në këtë drejtim a nuk po bashkëpunon policia apo çka është problemi?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) - aty ku ndërprehen komentet e Ligjit aty ndërprehen kompetencat tona, ne konstatojmë dhe e njoftojmë policinë ku mund të themi se policia ka treguar gatishmëri me këtë rast, por është momenti ku duhet me vepruar Institucionet tjera. Sepse ne nuk kemi të drejtë me konfiskuar teknologji ne e vendosim shiritin, por ne sot e vendosim shiritin, kompania e hjek nesër. Këtu përveç arrestimit të personit duhet të bëhet edhe konfiskimi i teknologjisë ne nuk e kemi në kompetencë.

Berat Buzhala - a ka ndodhur ndonjëherë që ne prezencën e inspektorit policia me arrestuar ndonjë shkelës të ligjit sipas kërkesës suaj?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) – jo. E kemi thirr shumë herë policinë edhe shumë edhe shumë aktivitete kemi bërë me policinë.

Berat Buzhala - d.m.th policia nuk bashkëpunon në këtë drejtim.

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) – policia bashkëpunon.

Berat Buzhala – pra, pse nuk është arrestuar askush?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) – tha se pritet harmonizimi i Ministrisë së punëve të brendshme me u harmonizua edhe me konfiskim e teknologjisë, ndoshta reflekton pak banalitet në terren por edhe kjo ndodh. Lidhur me 268 kallëzimeve penale nuk është bërë sepse procedura e aktpadisë penale duhet të reflektohet dhe të pritët një fuqizim sa ma i madh cili është fuqizim se duhet të shkojë te gjeodeti edhe ta konstatoj sasinë e parë të lëndës minerare. Me qenë

se kemi të bëjmë me një staf ku krejt stafi është i përbërë prej katër (4) vetave, dhe këta (4) katër veta nuk mund ta bëjnë këtë matje për fat të keq. Kjo ndodh sidomos më rrëzë dhe zhavorr, matjet janë të përmasave të vogla por në numër shumë të madh.

Kryetari – theksoj se prej 170 kallëzimeve penale vetëm 6 të gjykuara, kjo është no sens, me qenë se Kodi i Procedurës Penale mundëson pse nuk është parashtruar ndonjë padi private në emër të KPMM-së?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM-së) – këtu kemi të bëjmë me qasje të departamenteve relevante në kuadër të institucioneve ku kyçen zyret ligjore, departamenti i resurseve njerëzore, departamenti i gjeodezisë, edhe i mbledhin argumentet, dhe zyra ligjore i procedon në gjykatë.

Kryetari – theksoj se në përgjigjen e juaj shihet hapur që është një problem serioz edhe që ju e keni trajtuar, pyetja ishte se a është ndonjë ide që u'a mundëson Ligji për me i mbrojtë këto resurse.

Sala Berisha Shala- theksoj se dihet se operimet ilegale kanë qenë problem për këtë institucion, dhe e keni paraqitur edhe në Raport. Sa ka arritur KPMM-ja të koordinoj me komunat, përkatësisht inspektorët komunal, në lidhje me ndërprerjen e operimeve ilegale? A keni përkrahjen e tyre? Sepse dihet që ka qenë një regjion i tërë i disa komunave të cilat nuk e kanë njohur KPMM-në si institucion.

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM-së) – është një pyetje shumë konkrete. Disa komuna kanë bërë taksa edhe jashtë ligjit, kemi pasur takim me ishministrin e pushtetit lokal edhe pasi që kjo është antiligjore, dhe janë ndalur të gjitha taksat komunale.

Myzejene Selmani – theksoj se Raporti i sivjetmë mund të thuhet se është në gjendje më të mirë se vitin e kaluar, të cilin e patët prezantuar në mandatin e kaluar. Duke e marrë parasysh se ne e kemi miratuar Ligjin për Miniera dhe Minerale, kemi dhënë mundësi më të mëdha këtij institucioni. Dhe njëkohësisht tani i keni të gjitha në Ligj dhe shpresoj që edhe formimi i agjencionit do tua jap mundësinë në të mirë të rentave minerare që ti ndihmoni buxhetin e Kosovës. Se kjo kishte me qenë linja më e lehtë që këta operator ilegal njëherë e përgjithmonë të shuheshin sepse është e vështirë hapësira ku këta kontrollojnë të operohet pikë e për pikë.

Teuta Sahatqia – pyeti se a keni analizuar ndonjë propozim se si mund të bëhet një koordinim më i mirë? Sepse siç po kuptohet ekziston një mungesë e koordinimit në mes të shumë institucioneve. Edhe si mungesë e atij koordinimi pësojnë bizneset të cilat janë duke vepruar në mënyrë legale derisa vazhdojnë të operojnë biznese që operojnë ilegalisht. Ne duhet ka kemi ndonjë sugjerim se si do mund të përmirësohet koordinimi në mes të këtyre akterëve që të ketë një veprim sa më të mirë.

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM-së) – më herët e kemi punuar edhe një ide e cila mund të hyjë në implementim. Është ideja e bllokut të evidencës së mallit i cili transportohet me mjete transportuese në harmonizim me policinë të bëhet verifikimi i transportuesve që transportojnë resurse minerale për tu bërë konfiskimi. Pra gjithçka po lidhet rreth konfiskimit nuk është në kompetenca të KPMM-ja menaxhimi i mallit të konfiskuar.

Hashim Deshishku- pyeti lidhur me faturimet të cilat janë bërë për vitin 2010-të, a është kjo në rregull që të realizohen rreth 86% e inkasimit? A është një përqindje normale? A ka mundur të inkasohet edhe më shumë? Ndërsa, pyetja tjetër ka të bëjë me obligimet e vitit të kaluar, gatë vitit 2007-2008-të dhe 2009 a keni bërë ndonjë kamat ndaj atyre që nuk kanë paguar? Po ashtu

edhe lidhur me inkasimin e Trepçës që i keni 1 milion 300 mijë euro, a janë të inkasuara nga Trepça? Çka është në pyetje pse Trepça nuk i ka paguar? A ka probleme financiare apo ka borxhe?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM-së) – Trepça është një aset gjithëkombëtarë dhe të gjitha institucionet kanë bërë çmos që të ruhet si aset. Këtu ka qenë e involvuar edhe Qeveria edhe Ministria e Financave. Ne e kemi bërë kategorizimin e parë si cilësi por lirimi është nga sugjerimi nga Qeveria, kurse inkasimi nuk është 86%, por se 100% e kemi rrit inkasimin.

Azem Rexhaj (Drejtor ne KPMM) - në lidhje me inkasimin dhe faturimin e vitit 2010 KPMM-ja, ka faturuar 5 milion e 299 mijë e 546 euro, ndërsa ka inkasuar 4 milion e 583 mijë euro. Dallimin në mes të faturimit dhe inkasimit ka qenë se në vitin 2010 janë inkasuar do mjete që kanë mbetur të pa inkasuar qysh prej vitit 2006 e tutje, p.sh kemi Sharrcemin i cili nuk ka paguar asnjëherë deri në vitin 2010. Ndërsa në fund të 2010 ka paguar i milion e 400 milion euro. Sa i përket kamatave kemi filluar me i qit kamatat, por në vitin e kaluar është ngritur si kontekst për shkak se në Ligjin për Miniera dhe Minerale nuk është paraparë që KPMM-ja ka të drejtë ti qet kamatat. Por për mos pagesën e rentës minerare tash zyra ligjore është duke i shqyrtuar bashkë me administratën tatimore, dhe me zyrën ligjore të Ministrisë së Financave, që të jepet mundësia që të aplikohet Ligji i administratës tatimore të Kosovës që të ketë mundësi të aplikohet edhe për rentet minerare.

Ramiz Kelmendi – pyeti se sa është numri i kompanive të licencuara? Dhe sa është vlera financiare e jashtme e këtyre kompanive të mëdha Trepçës dhe Sharrcemit?

Azem Rexhaj (Drejtor ne KPMM) - gjithsej në Kosovë i kemi të licencuara mbi 500 kompani. Mirëpo licencat për hulumtim nuk shfrytëzohen këto kanë të drejt vetëm të hulumtimit që nuk krijojnë obligime të rentit minerarë apo diçka tjetër.

Ramiz Kelmendi - andaj kemi një numër të madh të denoncimeve, në raport me numrin e regjistruar. A ka vështirësi në regjistrimin e shfrytëzimit të mineraleve? A ka vështirësi një kompani me u regjistruar për shfrytëzimin e këtyre mineraleve, licencimi, marrja e licencës?

Azem Rexhaj (Drejtor ne KPMM) - duke e marrë parasysh se kemi shumë kompani të cilat nuk e kanë një staf të kompletuar dhe për tu kompletuar një staf ligjor duhet procedura jashtëzakonisht të ngarkuara procedura burokratike.

Ramiz Kelmendi – theksoj se ne si komision paskemi një mundësi që këto procedura të stërngarkuara mundësisht ti lehtësojmë, që njerëzit mos të vinë ndesh me Ligjin. E dyta e cila është shumë me rëndësi është të gjithë këta operuesit ilegal të cilët ekzistojnë edhe shumë të tjerë të legal duhet që produktin e vet që ta shesin në formë të zezë për arsye se se kanë të rregulluar çështjen e faturimit. Prandaj implementimi i formës fiskale te operatorët të cilët i shfrytëzojnë këto resurse e mundëson që ky informalitet të zvogëlohet. Pra sa më parë duhet të shkohet në legalizimin e fakturantëve të shfrytëzuesve të këtyre resurseve e pastaj të bëhet Ligji i konfiskimit të pajisjeve industriale që njerëzit po duhet me operuar për shkak se kemi informalitet të shfrytëzimit.

Sala Berisha Shala - theksoj se në faqen 50 në Raport, obligimet e realizuara janë paraqitur si të realizuara. Pyeti sa janë realizuara të hyrat e kompanive të mëdha në Kosovë siç është Ferronikeli, KEK-u? Dhe kërkoj informacion shtesë që duhet ti bashkëngjiteni këtij Raporti në ditët e ardhshme, të paraqiten të gjitha kompanitë sa i kanë kry obligimet edhe jo në këtë formë siç është vetëm për Trepçën. Ju e dini se Trepça e ka pasur një licencë të përkohshme një muaj apo dy muaj, duke e ditur se Trepça është një gjigant, e drejta e juaj është ti ngarkoni kompanitë

me një listë të tantiemave sepse është shumë me rëndësi të dihet shfrytëzimi i atyre kompanive, shfrytëzimin e mineraleve metalike .

Azem Rexhaj (Drejtor ne KPMM) - sa i përket listës së tantiemave që a kemi të drejt të aplikojmë në mënyrë retroaktive, kompanitë ngarkohen me pagesë për listën e tantiemave që në atë kohë ka qenë në fuqi, jo me tantimen që është tash edhe për kërkesën e Trepçës për dëmshpërblim. Trepça ka qenë pa licencë 30 ditë dhe duke e pasur parasysh bazën Ligjore KPMM-ja s'ka pasur Bord dhe për këtë shkak apo arsye në mungesë të Bordit nuk ka mundur ti vazhdohet licenca, sepse Trepça nuk i ka plotësuar kriteret sipas Rregullores 2005/3 për tu pajisur me një licencë të rregullt. Ndërsa Bordi në vitin 2010-të duke e shfrytëzuar Nenin 49-të të Ligjit për Miniera dhe Minerale, që i kemi në licencat në interes publik d.m.th e ka konsideruar Trepçën si një ndërmarrje me një interes publik, dhe e ka lëshuar licencën e rregullt me afat dy vjeçar.

Enver Breznica (Kryeinspektor i KPMM-së) - Tha që ka udhëzues së çka duhet të këtë për licencimin e kompanive legale. Ndërsa kompanive ilegale ju është vendosur shiriti dhe ju është lëshuar raporti për veprimtari ilegale dhe ju janë përgatitur lendet nga zyra ligjore e KPMM-së për veprime të mëtutjeshme në Gjykatë. Prej këtyre i kemi 117 raste që janë baza të betonit dhe asfaltit, ndërsa kemi 150 raste të kompanive, gurëthyesve po ashtu edhe individ. Të gjitha këto veprim që i kemi ndërmarr gjatë vitit inspektorati i ka lëshuar 268 ndalesa.

Hashim Deshishku – pyeti se çka keni ndërmarrë ju KPMM-ja për kompanitë që nuk janë përmbajtur kushteve të licencimit lidhur më ambientin?

Enver Breznica (Kryeinspektor i KPMM-së) - tha që kemi raste të tilla kompanive që krijon pluhur dhe kemi evidence për çdo kompani edhe afatet e caktuara të inspektimit. Në inspektimet vjetor hyjnë edhe të gjitha kompanitë që janë të licencuar se sa po ju përmbahen kushteve, dhe ju kemi caktuar afatet kohorë për me vendosur filtrat për pastrim.

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) - tha që është shumë e vërtet që shumë operues të legalizuar nuk janë konform kriterëve ambientale dhe nuk i përdorin filtrat për mos ndotje të ambientit për rreth gurthyesve. Por arsyeje është që të bashkëpunojmë që në të ardhmen e shkurtër t'i vendosin filtrat dhe mos diskriminohen karshi operuesve ilegale.

Kryetari - pyetje për tantiema se cilat janë kompetencat e KPMM-së për kompanitë e mëdha dhe a pritet ndonjë ndryshim rreth vlerësimit të tyre?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM- së) - tha se ne me Ministrin e financave do ta ndryshojmë, listën e tantiemave, dhe këto rregullohen më parametrat shkencor së sa shfrytëzohen.

Berat Buzhala – pyeti në lidhje më rastin që ka qenë vitin e kaluar kur një katërbëdhjetë (14) vjeçar e ka humbur jetën, prej një gropë që është hapur nga një kompani e licencuar, se çfarë masa janë ndërmarrë ndaj asaj kompanie? A ka limite të lëshimit të licencave për shfrytëzim duke pasur parasysh së Kosova është vendi i vogël me territor dhe deri kur mundem më dhënë licenca? Ju përmendet bashkëpunimin e mirë që keni më Ministrinë e planifikimit Hapësinor edhe tani ku është problemi kyç ku dështon policia, Ministria e ambientit dhe KPMM-ja dhe a mundem më qene të informuar ne si Komision për këtë raport?

Enver Breznica (Kryeinspektor i KPMM-së) - tha në këtë rast kam qenë edhe vete më Komision, dhe kemi bërë fotografimin edhe incizimin e vendit ku ka ndodhet aksidenti. Masa

jonë ka qenë së është përgatitur raporti dhe është përcjell në gjykatë. Kompanisë i është ndaluar puna deri në zhvillimet e mëtejshme të procedurës.

Berat Buzhala - pyeti se a'i është ndërpre puna asaj kompanie?

Enver Breznica (Kryeinspektor i KPMM-së) – po, që i është ndërpre puna.

Azem Rexhaj (Drejtor i KPMM- së) - theksoj së është praktik e KPMM-së dhe rregull që kur ka ndonjë incidente më operatorët, atëherë Komisioni shkon në terren dhe përgatiten raportin. Vdekja e djaloshtit ka ndodhur në një gropë të bere nga një operator legal dhe kompanisë ju është revoku licenca që e ka pas për shfrytëzim, ndërsa për informim të juve, prapë e kemi raportin inspektorit që ai ka vazhduar të punoj ilegal.

Hashim Dëshishku – pyeti, pse ky rast nuk është paraqitur në Raport vjetor?

Azem Rexhaj (Drejtor i KPMM- së) – nuk kishte përgjigje rreth kësaj pyetje. Ndërsa sa i përketë kufizimit të dhënies së licencave të kompanive, KPMM- ja punon me ligjin për miniera dhe minerale, bazë të ligjit nuk ka mundësi që ne si institucion t'i reduktojmë licencat. Strategjitë për miniera dhe minerale i përgatitë Qeveria dhe më anë te politikave mund të udhëzoj që në një hapësirë të mos lejohet shfrytëzimi. Ne qoftë së KPMM- ja nuk jep licenca në një hapësirë të caktuar ku mund të ketë edhe operues tjerë atëherë ne mund ta shkelim ligjin sepse nuk lejojmë konkurrencë e lirë. Mirëpo më politika dhe strategji mundet të bëhet saktë kufizimi i fushave të caktuara për interes publik nga Qeveria.

Berat Buzhala - tha qe ka shumë shtete që kanë tregun e vetë, mirëpo nuk e shfrytëzojnë. Për shkak të pasojave të ambientit që munden më ndodhe. Ju s'i institucion a mundeni me kërkuar edhe a keni mundësi prej institucioneve tjera që me vendos do limite në lëshimin e licensave?

Myzejne Selmani - tha më qenë së Plani hapësinor i mungon Kosovës, kërkoj nga KPMM- ja që zbatohet në mënyrë striktë Ligji për miniera dhe minerale. Theksoi që ka procedura shumë burokratike për licenca punë për shfrytëzim të hapësirave, por këto janë pasurit e Kosovës dhe duhet respektuar të gjitha institucionet duke filluar nga komuna dhe ministrit e linjave përkatëse sepse këtu është një kontroll më i mirë. Andaj Raporti e ka përfshirë gjendjen faktike të KPMM-së duke u bazuar në Ligjin për miniera dhe mineral. Dhe kërkoj që në bazë të ligjit që kanë operatorët për çdo tre (3) muaj të raportojnë në KPMM, dhe këto raporte të i'a sëllin më shkrim edhe Komisionit funksional për informim.

Sala Berisha - Shala - Tha që në kuadër të kësaj ne dimë së nuk duhet ta ngufatim konkurrencën e lirë, sepse ne jemi përcaktuar për këtë. Andaj në KPMM është investuar në një projekte në planin e guroreve të Kosovës, që ju KPMM- ja jeni të obliguar t'i përmbaheni? Pyeti sa aplikacione i ka kompania Bektel-Enka në KPMM? Dhe a ka marr licencë të shfrytëzimit? Dihet që materiali që shfrytëzohet gjatë trasesë si lende pare këto nuk ka diçka të keqe. Mirëpo duke e parë numrin e aplikacioneve në këtë material, dyshimi lind kur e dimë që është e kufizuar më ligj edhe numri i licencave që jepen dhe më sipërfaqe. Pyeti se a ka ndonjë obligim si KPMM ndaj Bektel-Enka, më ndonjë marrëveshje apo strategji qeveritare? Kishte pyetje sa është duke u zbatuar Ligji për miniera dhe minerale dhe konkretisht për Departamentin e Gjeologjisë? Ku është dashur të jetë në kuadër të Ministrisë së zhvillimit ekonomik. Për licencat për hulumtimet të vjetra, sa keni informate për këtë çështje nga kompanitë që shfrytëzojnë hapësirat? Sa keni pas mundësi t'i përcjellin kompanitë më licenca për hulumtimin për minerale? A kanë krye hulumtim sipas programeve dhe kriterëve që janë paraqitur nga KPMM-ja? Nëse një kompani nuk i'u ka përmbajtur ligjit si keni vepruar në ato raste? Kur këto kompani kanë aplikuar për vazhdimin e licencave të hulumtimit? Të licencat kompanive të posaçme sipas ligjit siç janë:

licencat për gjeologji vetëm një kompanie i është dhënë licenca dhe sa të tjera veprojnë ilegalisht? Ambienti të tokat e shfrytëzuara sa është rehabilituar pastaj ajo hapësirë e shfrytëzuar sepse në Ligjin për miniera dhe minerale është një kapitull veçantë që e parasheh këto çështje ambientale? Sa po koordinohet KPMM-ja me Ministrinë e ambientit dhe planifikimit hapësinor lidhur me ambientin, si p.sh. me rastin e KEK-ut, Trepçës dhe Ferronikelit? Ku dihet së këto janë ndotësit më të mëdhenj të ambientit? Për kompanitë projektues sa janë në harmoni me ligjin? Sepse po ka kompani që nuk po e zbatojnë kriteret sa i përket distancave të objekteve, rrugëve dhe parqeve nacionale? Sa janë profesionale kompanitë kur dihet së në dy apo më shumë kompani ka të njëjtin profesionist? Keni pas obligim që tre (3) muaj par skadimit të mandatit të anëtarit të Bordit ta njoftoni Kuvendin, pse se keni bërë këtë në afatin kohor?

Ahmet Tmava (Kryetar i Bordit të KPMM-së)- u përgjigj në pyetjet e deputetëve si në vijim: për konkurrence hulumtuese dhe që në mandatin e KPMM-së, është që çdo kompanie që konkurren ti japë licence hulumtuese, dhe kjo ia vlen sepse mbeten aset dhe projekte të qeverisë për të ardhmen; për planin e gurores, ligji i ri e parasheh në mënyre decitive së me afër së 500 metra ku ka objekte dhe vendbanim që mund të dëmtohen, mos të ipet asnjë licencë, por ka ende licenca më ligjit vjetra dhe ato janë ende duke u zbatuar, dhe KPMM-ja është duke bërë një strategji që këto kompani të transferohen në ato vende ku nuk pengojnë. Sepse ne nuk mund të ua marrim licencat që të bëhem shkaktar të falimentimit të tyre; Bektel-Enka edhe pse ka bërë shumë kërkesa për shfrytëzim të sipërfaqeve për eksploatimit të lendes së parë zhavorrit nuk i kemi dhënë, nuk ka pas asnjë marrëveshje për këtë çështje. Përveç sasisë së lendes së parë që e nxjerr nëpër trase atë e shfrytëzon, kjo ka qenë marrëveshje e kontratës me Qeverinë, dhe jashtë kësaj nuk ka asnjë licencë për eksploatim të lendes së parë; plani hapësinor është kompetencë e Ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapësinor; për licencat për shfrytëzim disa kompani janë ende duke punuar me ligjin vjetër, derisa të ju përfundojë koha e licencave. Për burokracinë e regjistrimit të marrjes së licencave, është procedurë për më dhënë pëlqim komnat, Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor, Ministria e Bujqësisë dhe pylltarisë, është një procedurë që e minimizon mundësinë e keqpërdorimit dhe institucioni i KPMM-së nuk jep licenca pa pëlqimin e gjitha këtyre institucioneve; për zbatimin e ligjit ne deri tani për shkak të reflektimeve politike nuk kemi mundur ta zbatojmë në tërësi për shkak të disa procedurave që kanë dal kur është miratuar ligji në Kuvend, më një herë kanë filluar të mbahen zgjedhjet përgjithshme; për skadimin e mandatit të një anëtarit të Bordit tha që ne kemi dërguar shkresën më kohë për njoftim zyrtarisht në Kuvend; se a janë keqpërdorur licencat e hulumtimit, ato lëshohen për dy (2) vjet nga KPMM-ja, dhe vazhdimisht i mbikëqyrë kriteret e vlerësimit, nëse nuk ju përmbahet rregullave nuk ju vazhdohet licenca e hulumtimit dhe zonat mbesin të lira; sa përket zbatimit të ligjit, në lidhje për institutin e gjeologjisë, tha që departament nuk është kompetencë e jona, kjo është Ministrisë së zhvillimit ekonomik, për më fut në lëvizje këtë institut; për hulumtimet e vjetra tha që nuk ka mundësi më marr dikush diçka pa pëlqimin pronarit, kjo tani është më interes veçante si zonë, dhe i takon Qeverisë që ka të bëjë me Trepçën; se a ka leje të veçanta për shpime të puseve kanaleve tha që asnjë kompani këto nuk mund të kryhen punimet pa pëlqimin e pronarit; se sa janë profesionale kompanitë dhe sa gjeologë janë të punësuar tha që është çështje e kompanive; për rikultivimin e tokave tha që tani më është e rregulluar më ligj së ajo kompani që e fiton licencën, pasi ta mbaroj shfrytëzimin e lëndës së parë ta rikultivoj atë hapësirë, tokë; për kompanitë projektuese për publikimin e projekteve tha që tani e kanë përfunduar punën dhe do të bëjnë publike ato në gjuhët zyrtare.

Pas debatit të gjerë Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010.

dhe Kuvendit i parashtrohet këtë:

Rekomandim

1. Të miratohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjeve: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme;

Kryetari – kërkoj nga deputetët të miratohen në parim veç e veç këto projektligje dhe të formohet një grup punues prej 3 deri në 5 deputet për të amendamentuar projektligjet në rend dite.

Myzejene Selmani – theksoj se të tri projektligjet nuk i plotësojnë kushtet për miratim në parim. Projektligji nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare është i njëjti që ka qënë në mandatin e Qeverisë së kaluar dhe nuk ka asnjë ndryshim, projektligji nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim është më shumë një udhëzim administrativ sesa një ligj, pastaj projektligji nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme është konfuz dhe i hartuar mjaft keq. Duke marr parasysh këto propozoj që të tri projektligjet ti kthehen Qeverisë për rihartim dhe të sjellen në qershor në Kuvend për shqyrtim.

Lutfi Zharku – theksoj se Projektligji nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare, është i njëjti ai që është hartuar në kohën sa ka qënë ministër dhe madje nuk janë përfshirë së paku vërejtjet e Bankës Botërore që është dashur të përfshihen si pjesë e këtij projektligji.

Sala Berisha - Shala – theksoj se duhet Komisioni të miratojë në parim, pastaj vërejtjet dhe propozimet mund të bëjmë përmes amendamentimit në Komision dhe mund të përmirësohen këto projektligje në mënyrën më të mirë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

1. Shtyhet shqyrtimi në parim i Projektligjeve: nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme.
2. Në mbledhjen e radhës të ftohet Ministria e tregtisë dhe industrisë, në cilësinë e sponsorizuesit të arsyetoj projektligjet e proceduara për shqyrtim.

5. Të ndryshme;

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Zenun Pajaziti
Kryetar i Komisionit**